

BASHKIA TIRANË

VENDIM

Nr. E-17054/2

PËR

Miratimin e lejes së ndërtimit për "Rikonstrukcion i pallatit ekzistues 6 kate (Nr. 3/1), të dëmtuar si pasojë e fatkeqësive natyrore, pa shtim apo ndryshim vëllimi", në rrugën "Ali Ndroqi", Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë , me subjekt zhvillues Bashkinë Tiranë dhe subjekte ndërtuese shoqëritë "Ergi" sh.p.k dhe BE-IS" sh.p.k.

Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b"; nenin 23, pika 14; nenin 64 shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar); Nenin 24 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 për "Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar); Ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile"; Aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"; Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", (i ndryshuar); Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore" (i ndryshuar); Urdhëresën e Kryetarit të Bashkisë nr. 8741, datë 21.03.2016 "Për procedurën e shqyrtimit të aplikimeve të lejes së zhvillimit/ndërtimit, deklarata paraprake për kryerje punimesh, çertifikatë përdorimi, gen-plane azhurnimi dhe përditësimet e infrastrukturave të tjera" (e ndryshuar); Urdhrin nr. 11987, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë "Për ngritjen e Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë" (i ndryshuar); Manualin e Procedurave dhe Organizimit të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim nr. 11987/1, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë (i ndryshuar); si dhe mbështetur në opinionin e datës 20.11.2024 të Këshillit Teknik, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së dorëzuar elektronikisht me numër aplikimi AN221020240019 dhe protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr. prot. E-17054, datë 22.10.2024, për leje ndërtimi për "Rikonstrukcion i pallatit ekzistues 6 kate (Nr. 3/1), të dëmtuar si pasojë e fatkeqësive natyrore, pa shtim apo ndryshim vëllimi", në rrugën "Ali Ndroqi", Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë , me subjekt zhvillues Bashkinë Tiranë dhe subjekte ndërtuese shoqëritë "Ergi" sh.p.k dhe BE-IS" sh.p.k.;

VENDOSA:

1. Të miratoj leje ndërtimi për "Rikonstrukcion i pallatit ekzistues 6 kate (Nr. 3/1), të dëmtuar si pasojë e fatkeqësive natyrore, pa shtim apo ndryshim vëllimi", në rrugën "Ali Ndroqi", Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë , me subjekt zhvillues Bashkinë Tiranë dhe subjekte ndërtuese shoqëritë "Ergi" sh.p.k dhe BE-IS" sh.p.k., sipas projektit të hartuar nga projektues të licensuar, ngarkuar në sistem;

2. Afati i lejes së ndërtimit është 7 muaj, sipas grafikut të punimeve. Ky afat fillon nga data e fillimit të punimeve të ndërtimit;
3. Bazuar në nenin 25, 36 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"; në nenin 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar) *rindërtimi dhe rikonstrukcioni i banesave përjashtohet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifa e aplikimit të zbatueshme për lejet e ndërtimit*;
4. Për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike sipas projektit, të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen probleme në rrjetin publik;
5. Pas përfundimit të punimeve të kthehet territori rrethues në gjendjen e mëparshme, të riparohen të gjitha dëmtimet në rrugë, trotuare, etj;
6. Të mos bëhen ndryshime nga projekti i hartuar nga projektues të licensuar, i ngarkuar në sistem, pa miratimin paraprak nga Bashkia e Tiranës, sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi;
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

ERION VELIAJ

Drejtor i Përgjithshëm DPPZHT:	Anisa Lila
Drejtor i DLZHT:	Dition Shkurtaç
Drejtor i DMT:	Donalda Mustafaraj
Përgjegjëse ST(e deleguar):	Diana Prifti
Specialist jurist SLZH:	Isan Goxhi
Specialist ST:	Matilda Sotiri